



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 21.3.2013, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sami Hamiti, Mustafë Krasniqi, Tefik Mehmeti, Hazir Borovci, Aziz Pacolli, Engin Beyoglu, Milazim Vitia, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesit e OSBE - së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Hamiti, kryesues.

Njëzëri u miratua ky

### REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë;
2. Raporti i punës për vitin 2012 i NPK “Ndërmarrja Banesore”;
3. Raporti i punës për vitin 2012 i NPK “Termokos”;
4. Raporti i punës për vitin 2012 i NPK “Sport Marketing”;
5. Raporti i punës për vitin 2012 i NPK “Stacioni i Autobusëve”;
6. Propozimrregullorja për transportin rrugor në territorin e komunës së Prishtinës;
7. Propozimrregullorja për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Prishtinës;
8. Të ndryshme.

Pika e parë

Milazim Vitija bëri vërejtje në pikën e dytë të ekstraktit, duke thënë se duhet të jetë: “... se vitin e kaluar është bërë një punë e mirë në ndihmën e fermerëve dhe të blegtorëve.”, dhe në fund të diskutimit duhet të jetë: “Të shikohet mundësia për

rihapjen e Ambulancës mjekësore në Flotacion dhe të hapet një vend pune për një teknik medicinal.”

**Mustafë Krasniqi** bëri vërejtje në pikën e gjashtë, duke cekur se në vend të fjalës “të ngrihet”, duhet të jetë: “të ngritet”.

**Me vërejtjet e dhëna, njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

**Pika e dytë, e tretë, e katërt dhe e pestë**

**Shefqet Sylejmani** vlerësoi se të gjitha raportet e ndërmarrjeve kanë një performancë të mirë dhe për ne janë të pranueshme.

Sa i përket Ndërmarrjes Banësore, kapitali i ndërmarrjes është ai që ka qenë për ato asete dhe ka një afarizëm pozitiv. Kjo ndërmarrje pritet të kalojë me investime në objekte të reja. Çështja e arkëtimit të qirave mbetet një ndër problemet që janë të lidhura ngushtë me procedurat gjyqësore.

**Aziz Pacolli** kryesisht diskutoi rreth NPK “Sport Marketing”, duke thënë se më herët janë marrë disa vendime për t’i ndihmuar kësaj ndërmarrjeje, konkretisht për rregullimin e pishinës, andaj kërkoj të dijë se në këtë vit a do të fillojnë punimet. Për raportin e punës së NPK “Stacioni i Autobusëve”, tha se është dhënë një raport i shkurtër, me një arsyetim të vogël.

Për projektet e parapara në pishinën e Gërmisë, **Kryesuesi** tha se për këtë vit janë pjesë e investimeve që pritet të realizohen.

Lidhur me raportet e këtyre ndërmarrjeve, **Kryesuesi** paraqiti sqarime shtesë.

**Shemi Veseli** vlerësoi se në përgjithësi këto raporte nuk janë në nivelin e duhur, ato po i hartojnë kryeshefat dhe po i nënshkruajnë aksionarët. Në këto raporte ka shumë mangësi. Edhe ligji i parasheh disa çështje të ndërmarrjeve, por këtu punët nuk janë duke i kryer ashtu si duhet. Ndërmarrja “Termokos” disa herë është ndihmuar me mjete financiare dhe prapë mungon nxehja, arkëtimi i borxheve jo i kënaqshëm dhe duhet të mendohet për metodat e shlyerjes së tyre. Mungojnë planet e biznesit, nuk janë formuar politikat e monitorimit, mungojnë strategjitë afariste – financiare, mungojnë deklaratat gjithëpërfshirëse lidhur me realizimet, mungojnë raportet mbi përmbushjen e nevojave të klientëve etj.

Me gjithë këto vërejtje dhe sugjerime, këto raporte i përkrahim për miratim.

**Tefik Mehmeti** tha se është jo e drejtë të krahasohet raporti i ndërmarrjes “Termokos” me raportet e ndërmarrjeve tjera, pasi që kjo ndërmarrje ka specifika të tjera.

Menaxhimi është treguar i suksesshëm në këtë ndërmarrje, por do të kalojë kohë e gjatë për sanimin e pasojave të pasluftës në Termokos. Problem kryesor për këtë ndërmarrje mbetet arkëtimi, sepse asnjë padi e Termokosit nuk po zbatohet, andaj duhet menduar se si të ndryshojë qasja e qytetarëve që t’i kryejnë detyrimet ndaj ndërmarrjes.

**Agim Salihu** paraqiti një raport, si model për raportet e ardhshme të ndërmarrjeve publike lokale.

**U konstatua se njëzëri u përkrahën: Raporti i punës për vitin 2012 i NPK “Ndërmarrja Banesore”, Raporti i punës për vitin 2012 i NPK “Termokos”, Raporti i punës për vitin 2012 i NPK “Sport Marketing” dhe Raporti i punës për vitin 2012 i NPK “Stacioni i Autobusëve dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

### **Pika e gjashtë**

**Lidhur me Propozimrregulloren për transportin rrugor në territorin e komunës së Prishtinës, Agim Salihu** tha se Komuna e Prishtinës e ka një rregullore që rregullon transportin rrugor, por nuk ka qenë e harmonizuar me Ligjin për transportin dhe me propozimet e drejtorisë përkatëse, andaj duhet ta bëjmë një tekst të spastruar.

**Tefik Mehmeti** bëri vërejtje në nenin 2, duke kërkuar që ai të jetë më i sqaruar, në nenin 15, pikat b dhe c, në nenin 16, pika 2, në nenin 17, në nenin 18, pika 5, në nenin 24, në nenin 31, pika 3, në nenin 40, pika 3 dhe në nenin 45, pika d.

**Aziz Pacolli** shprehu shqetësim dhe dilemë, duke theksuar se me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje a do të rregullohet funksionimi i rregullt i komunikacionit.

Njëherësh ai kërkoi të dijë se kontrollorët e trafikut urban a do të jenë edhe për autobusët e sektorit privat.

Rreth funksionalizimit të kësaj rregulloreje, **Agim Salihu** dha sqarime shtesë.

**Shefqet Sylejmani** tha se në ndërmarrjen “Trafiku Urban” ka probleme, dhe këtë e vërtetojnë edhe ankesat e shumta të qytetarëve. Aty është krijuar familjarizim, andaj është vështirë të menaxhohet ajo ndërmarrje. Në relacionet e Trafikut Urban ka vonesë deri në 45 minuta. Shprehu dilemën se a do të jemi në gjendje të krijojmë rregull, në mënyrë që kjo rregullore të zbatohet dhe qytetari të shprehë vërejtjet e veta dhe njëherësh të jetë bashkëpunues kryesor me pushtetarin. Ai kërkoi që për mbarëvajtjen e kësaj rregulloreje të kujdesen edhe menaxherët - drejtorët e linjave të trafikut.

**Kryesuesi** tha se në këtë rregullore janë të përcaktuara dispozitat që duhet zbatuar dhe për zbatimin e kësaj do të kujdeset edhe policia.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimrregullorja për transportin rrugor në territorin e komunës së Prishtinës dhe i dërgohet Kuvendit për miratim.**

### **Pika e shtatë**

Për këtë pikë të rendit të ditës, **Agim Salihu** tha se është qëndrim i Kryetarit të Komunës që të parasheh ndarjen e subvencioneve për arsim, në formë të bursave, për studentë të universiteteve publike dhe për kolegje private.

Kryesuesi shprehu mendimin që ndarja e bursave duhet të bëhet vetëm për studentë të universiteteve publike.

**Shefqet Sylejmani** përkrahu mendimin e kryesuesit, që ndarja e bursave të jetë vetëm për studentët e universiteteve publike. Më pas bëri vërejtje në nenin 3, pika 1,

dhe propozoi që kësaj pike t'i shtohet: "... qytetarë të territorit të komunës së Prishtinës, dhe propozoi që të caktohet lartësia e bursës.

**Mustafë Krasniqi** shprehu mendimin që shfrytëzues të bursës të jenë edhe studentët e kolegjeve private.

**Aziz Pacolli** tha se është për t'u përsëritur kjo rregullore, por do të ishte mirë që të përcaktohet edhe numri i studentëve se sa do të jenë përfitues të bursave.

Ai propozoi që përfitues të bursave të jenë vetëm studentët e universiteteve publike. Vërejtje bëri në nenin 9, pika f, duke kërkuar që kjo pikë të formulohet më mirë.

**Kryesuesi** tha se me rastin e ndarjes së bursave, gjithsesi duhet të bëhet një përzgjedhje e merituar.

**Tefik Mehmeti** propozoi që të merren parasysh disa kritere, të jetë për bazë Rregullorja për ndarjen e banesave, pra të caktohet një limit. Përveç këtij propozimi, vërejtje bëri në nenin 3, pika 2, në nenin 8, pika 1, në nenin 12, pika 1 dhe në nenin 13, pika 2.

**Shemsi Veseli** bëri vërejtje në nenin 9, pikat g dhe h, duke propozuar rritjen e pikëve, në nenin 13, pikat 1 dhe 2, ku propozoi zvogëlimin e afatit dhe kërkoi që përfituesit e bursave të jenë banorë të komunës së Prishtinës.

**Milazim Vitija** propozoi që në nenin 10 të shtohet edhe një kriter, që do të parashihte subvencionimin edhe për studentët që udhëtojnë në relacion më të gjatë se 20 km.

**Me plotësime dhe ndryshime dhe me propozimin që kjo rregullore të jetë vetëm për studentët e universiteteve publike, u konstatua se njëzëri u përkrash Propozimrregullorja për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Prishtinës dhe i dërgohet Kuvendit për miratim.**

#### **Pika e tetë Të ndryshme**

**Hazir Boroci** parashtrori çështjen që ka të bëjë me 52 shtëpitë në lagjen "Kodra e Diellit", duke thënë se është duke iu bërë një e padrejtë e madhe atyre pronarëve që, edhe përkundër vendimit për eksproprijim që është marrë në vitin 1985, ai vendim nuk është zbatuar asnjëherë. Ai kërkoi që të merren masa për zgjidhjen e këtij problemi.

**Shemsi Veseli** kërkoi që të iniciohet procedura për gjetjen e një lokacioni për ndërtimin e objektit të Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë. Ai gjithashtu ngriti dy shqetësime. E para, ka të bëjë me çështjen e narkomanëve në kompleksin e banesave "Dielli", në lagjen "Kodra e Diellit". Lidhur me këtë çështje kërkoi që të merren masa në parandalimin e kësaj dukurie. E dyta, është çështja e largimit të kontejnerëve, të cilët janë larguar një herë, por ata prapë janë kthyer dhe janë mbështetur në shtëpinë e një personi të paralizuar në afërsi të "Rezonancës" dhe kërkoi që kjo çështje të merret parasysh.

**Shfaqet Sylejmani** përsëriti prapë kërkesën, e cila ka të bëjë me ndarjen fizike të pronës në kompleksin “Dielli”. Ai luti anëtarin e Komisionit, z. Bexhet Musliu, i caktuar nga Kryetari i Komunës, ta finalizojnë punën lidhur me ndarjen e pronës që i takon Komunës nga pjesa e pronës së investitorit – ndërmarrjes “Stan-Glob”, që ishte koncesionar në ndërtimin e kompleksit banesor “Dielli”, në lagjen “Kodra e Diellit”. Me këtë do të mundësoheshin edhe veprimet e duhura dhe të nevojshme për dhënien e lejes për përdorim - shfrytëzim nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës. Lidhur me shqetësimet e ngritura nga z. Sylejmani dhe z. Veseli, **kryesuesi** tha se këto çështje do t’ia përcjellë Kryetarit.

*Mbledhja mbaroi në orën 17:40.*

**Procesmbajtësi**  
**Zijadin Gashi**

**KRYESUESI I KOMITETIT**  
**Sami Hamiti, ecc. i dipl.**